



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Državna Agencija za Zastitu Licnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

RE KOSOVË REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIK E KOSOVO	
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZASTITU LICNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARRIVIT - KANCELARIA ARCHIVA-ARCHIVE OFFICE	
Nr. Org. Org. Jedra Org. Unit	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No:
01	168
Nr. i faqeve Reg. stranca No. pages	Data Datum Date:
02	18/09/2013

Nr.37/13  
Datë: 17.09.2013

Në mbështetje të nenit 49 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ( Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 70/2010 ) zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr këtë:

### V E N D I M

1. Urdhërohet, Spitali Rajonal Daut Mustafa - Prizren të ndalojë përpunimin karakteristikave biometrike -gjurmët e gishtërinjve.
2. Urdhërohet, Spitali Rajonal Daut Mustafa- Prizren të bëjë shkatërrimin e të dhënave biometrike ( gjurmët e gishtërinjve).
3. Në afat prej 15 ditëve të njoftohet Agjencia për zbatimin e vendimit
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të vendimit.

### Arsyetim

Në bazë të nenit 46 paragrafi 1 dhe nenit 47 paragrafi 1 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ( në tekstin e mëtejme LMDHP), Agjencia ka realizuar inspektim të rregullt në Spitali Rajonal Daut Mustafa- Prizren me datën 30.08.2013

Inspektimi në Spitali Rajonal Daut Mustafa- Prizren është realizuar me qëllim të konstatimit të përpunimi i të dhënave biometrike-gjurmët e gishtërinjve.  
Pas kryerjes së inspektimi është përpiluar procesverbali me nr. 19/2013, ku një kopje e procesverbalit i është dorëzuar zyrtarit të pranishëm në inspektim.

Në bazë të inspektimit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Në Spitali Rajonal Daut Mustafa- Prizren, është konstatuar se bëhet përpunimi i të dhënave biometrike -gjurmët e gishtërinjve. Ky përpunim është në kundërshtim me nenin 66 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ku thuhet se sektori publik mund të përdorë karakteristika biometrike vetëm nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve për sigurinë e njerëzve për sigurinë e pronës ose për mbrojtje të të dhënave konfidenciale ose sekreteve të biznesit.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nenin 49, nënparagrafi 1.1 dhe 1.5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësi Kryesor Shtetërorë ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

### **Këshillë Juridike**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

zv. Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror

*Mentor Hoxha*  
**Mentor Hoxha**



Vendimi i dërgohet:

- Spitali Rajonal Daut Mustafa- Prizren
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë